



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 10 mars 2011
Nr. ref.: RK92/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 28/10

Parashtruesi

FAIK AZEMI

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në
Prishtinë, Ac. Nr. 5/2010, i 4 marsit 2010,**

dhe të

**Vendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 67/2008, i 23 dhjetorit
2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Faik Azemi, me banim në Prishtinë.

Objekti i çështjes

2. Çështje e lëndës së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese është mosekzekutimi i supozuar i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës, CI. nr. 515/2007, i 29 dhjetorit 2008, që u bë i plotfuqishëm dhe detyrues më 18 qershor 2009.

Shkeljet e supozuara të garancive kushtetuese

3. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar në mënyrë eksplicite cilat të drejta kushtetuese i janë shkelur, por ka theksuar se janë shkelur dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe dispozitat ligjore të *res judicata*.

Baza juridike

4. Neni 113(7) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedurat në Gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 18 janar 2010. Ajo u regjistrua më 28 prill 2010, pasi parashtruesi i kërkesës i dorëzoi dokumentet relevante.
6. Më 16 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarës raportuese Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Almiro Rodrigues (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Kadri Kryeziu, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Ankesa e parashtruesit të kërkesës

7. Parashtruesi i kërkesës ankohet se Gjykata Komunale në Prishtinë padrejtësisht refuzoi ta ekzekutonte Aktgjykimin e vet CI. Nr. 515/2007, të 29 dhjetorit 2008, pavarësisht që ishte i plotfuqishëm dhe "i ekzekutueshëm".

Përmbledhja e fakteve

8. Më 29 dhjetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin CI. Nr. 515/2007, me ç'rast e miratoi kërkesëpadinë e... [parashtruesit të kërkesës] dhe konfirmoi se e paditura, Drejtorja për Arsimit dhe Shkencë e Komunës së Prishtinës, në mënyrë të paligjshme ndërpreu kontratën e punës gjatë periudhës në fjalë, respektivisht prej 1 tetorit 2003 deri më 31 dhjetor 2007, ..., dhe e obligoi të paditurën e njëjtë t'i njihte të gjitha të drejtat [e parashtruesit të kërkesës] nga marrëdhënia e punës... nën kërcënimin për ekzekutim të dhunshëm.
9. Më 18 qershor 2009, aktgjykimi i sipërpërmendur u bë i plotfuqishëm dhe detyrues.
10. Më 17 korrik 2009, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi një propozim me shkrim Gjykatës Komunale të Prishtinës, si gjykatë kompetente për ekzekutimin e aktgjykimit të sipërpërmendur. Kërkesa e tij kishte të bënte në veçanti me pagesën prej 11,475 eurove në emër të rrogave të papaguara.

11. Më 23 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Vendimin E. nr. 67/2008 dhe e hodhi poshtë propozimin e parashtruesit të kërkesës për ekzekutim, duke sqaruar ndër të tjera se “aktgjykimi në fjalë nuk e gjykon shumën e kërkuar.” ...
12. I pakënaqur me këtë vendim, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
13. Më 4 mars 2010, Gjykata e Qarkut nxori Vendimin Ac. Nr. 5/2010 dhe e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazë, duke theksuar ndër të tjera se “kreditore [d.m.th. parashtruesi i kërkesës] ka të drejtë t'i ushtrojë të drejtat e tij për periudhën e sfiduar kohore nëpërmjet procedurës kontestimore për të ardhura personale ose rroga.

Vlerësimi pranueshmërisë të kërkesës

14. Duhet të theksohet që në fillim se ankesa e parashtruesit të kërkesës kufizohet në mospajtimin e tij me vendimin e Gjykatës së Qarkut, me të cilin konfirmohet vendimi i mëhershëm i Gjykatës Komunale të Prishtinës për refuzimin e propozimit të tij për ekzekutimin e pagesës në shumë prej 11,475 eurove.
15. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës i ankohet Gjykatës Kushtetuese se Gjykata Komunale padrejtësisht refuzoi ta ekzekutonte Aktgjykimin CI. Nr. 515/2007, pavarësisht që, sipas tij, aktgjykimi ishte i plotfuqishëm dhe “i ekzekutueshëm”.
16. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vëren që ekzekutimi i aktgjykimit, siç u kërkuar nga parashtruesi i kërkesës më 17 korrik 2009, kurrë nuk është lejuar.
17. Gjykata Kushtetuese vëren që më 4 mars 2010, Gjykata e Qarkut nxori Vendimin Ac. Nr. 5/2010, në të cilin theksohej ndër të tjera se “kreditore [d.m.th. parashtruesi i kërkesës] ka të drejtë t'i ushtrojë të drejtat e tij për periudhën e sfiduar kohore nëpërmjet procedurës kontestimore për të ardhura personale ose rroga.”
18. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 113(7) të Kushtetutës, i cili thotë:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
19. Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi se ka iniciuar procedurë kontestimore para gjykatës kompetente në Kosovë, siç sugjerohet nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë.
20. Arsytimi për shterimin e mjeteve ligjore është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli është bazuar në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (shih: Aktvendim për papranueshmëri, Universiteti AAB-RIINVEST shpk, Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 27 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).
21. Prandaj, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTË ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.4 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe Rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani